

REPUBLIC OF KOSOVO  
KOSOVAN REPUBLIC  
MINISTRY OF JUSTICE  
DPRK/DMP  
02  
03-3743/13  
06.11.2013

KA. nr.685/2013

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bilana Rexhiq kryetare e kolegjit, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtoren profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehuri Engin Hamdi Beyoglu, nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.nr.24904/2011, të dt. 16.10.2012, në bazë të nenit 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 14.06.2013, merr

## AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.nr. 24904/2011, të dt. 16.10.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

## Arsyetim

Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.nr.24904/2011, të dt. 16.10.2012, të pandehurin Engin Hamdi Beyoglu, nga Prishtina, e ka shpallë përgjegjës sepse:

Si Zyrtar i Lart Publik, në pozitën Zëvendës Kryesues i Kuvendit në Komunën e Prishtinës, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agresionin Kundër korrupsionit, brenda afatit ligjor deri me dt.31.03, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lart Publik, për të cilën kundërvajtje është dënuar me gjobë në shumë prej 1500 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur i pandehuri Engin Beyoglu për shkak të : aplikimit të gabuar dhe mos aplikimit të dispozitave të ligjeve në fuqi dhe vërtetimit jo të plot dhe të gabuar të gjendjes faktike, shton: në postin zv. Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës kam ardh si anëtar i komunitetit jo shumicë-me përkatësi turke, këtë po e ceku nga arsyeja se vendimi i marr është në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr.02/L-37,për përdorimin e gjuhës. Me qen se gjuha ime është gjuha Turke në pa mundësi të kuptoj në tersi formularin për deklarimin e pasurisë ,por edhe në seancën dëgjimore kam deklaruar se nuk e kam kuptuar qëllimin e të dhënave që janë kërkuar në formular. Andaj edhe nga kjo bazë vendimi i atakuar duhet të anulohet. Duke pas parasysh shkeljet procedurale dhe vërtetimin jo të plot të gjendjes faktike ,propozoj që aktvendimi i goditur të shqyrtohet ndërsa ai të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar.

03-3743/13/02  
fuz

Kolegji i Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje, pas vlerësimit të thënieve në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa është e bazuar, ndërsa aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet në gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në këtë çështje kundërvajtëse, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duhet bërë plotësimin e procedurës, meqë lind dyshimi i bazuar që i pandehuri është i kombësisë turke, ndërsa procedura nuk është zhvilluar në gjuhën e ti amtare, e këtë çështje i pandehuri e thekson edhe në ankesën e paraqitur.

Kolegji vlerëson se gjendja faktike nuk është kontestuese, me që i pandehuri në procesverbal pran gjykatës së shkallës së parë të dt. 05.03.2012, e ka pranua veprën kundërvajtëse e cila i vihet në barrë, mirëpo, nga procesverbali i njëjtë mundë të konstatohet se ai është udhëzuar për të drejtën e angazhimit të mbrojtjes profesionale, mirëpo nuk është deklaruar lidhur me kombësinë e ti, andaj për këtë arsye aktvendimi i goditur nuk mund të qëndroj dhe është abroguar.

Në plotësim të procedurës, gjykata e shkallës së parë është e obliguar që përsëri ta ftoj të pandehurin, dhe t,ia mundësoj mbrojtjen në gjuhën amtare, e pastaj të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtëse.

Më sa u tha më lartë konform nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

**GJYKATA E APEJIT E KOSOVËS**  
**KA. nr.685/2013, datë 14.06.2013.**

Procesmbajtësja  
Sebahate Hoti



PREZIDENTI I KOLEGJIT  
Biljan Rexhiq